



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës Jugore**  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**Komisioni Komunal i Aksionarëve të NP “Tregu”**

**Nr. 02-060/01-0068507/22-3 dt. 16.09.2022**

**Mitrovicë**

Komisioni Komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes Publike Lokale “Tregu”, Mitrovicë, bazuar në nenet: 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, në mbledhjen e mbajtur më dt. 16.09.2022 ka marrë vendim të **Rishpallë**:

**KONKURS**

Për zgjedhjen e katër (4) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për Ndërmarrjen Publike “Tregu”, Mitrovicë.

Mandati i anëtarëve të bordit është në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009.

**KUALIFIKIMET DHE PËRGATITJA PROFESIONALE**

- Të jetë person që ka integritet, të mos ketë çfarëdo shkelje fiduciare ndaj personave tjerë fizik dhe juridik;
- Të ketë përgatitje superiore;
- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në nivel të lartë menaxhimit – në fushën e administrimit të biznesit, të financave kooperative, financave, menaxhimi i thesarit, bankave, konsulent në biznes ose industri, ose nga fushat e tjera të shkencave ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së, ose të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlihet ngushtë me veprimtarinë afarist të N.P.-së.

Së paku 2 anëtarë të bordit duhet të jenë ekspertë, ose së paku të kenë njohuri adekuate, në kontabilitet.

**KUSHTET**

Kandidatët kanë të drejtë të zgjedhen në bordin e N.P.-së nëse:

- Nuk kanë qenë të dënuar dhe nuk janë nën hetime nga ndonjë gjykatë kompetente, nuk kanë shkelur Kodin e Etikës apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga gjykata ose nga ndonjë organ tjetër i ankesave;
- Nuk kanë bërë përgënjeshttrimin e materialit nën çfarëdo dëshmie nën betim, nuk kanë qenë në pjesë menaxheriale në ndonjë kompani që ka falimentuar në 10 (dhjetë) vitet e fundit.

### **Kandidatët nuk mund të zgjedhen në bordin e N.P.-së nëse:**

- Aktualisht është zyrtar apo menaxher i ndërmarrjes përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, ose ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj në 5 (pesë) vitet e fundit;
- Aktualisht ka, ose gjatë 3 (tri) viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materiale – afariste (përveç si konsumator individual i shërbimit të ndërmarrjes publike), me ndërmarrjen publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor zyrtar ose punonjës i lartë në ndonjë shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me N.P.-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon ose ka pranuar brenda 3 (tri) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga N.P.-ja përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike), ose anëtar në skemën pensionale të N.P.-së përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon 10% (dhjetë përqind) të aksioneve votuese në N.P.-në përkatëse;
- Ka shërbyer në bordin e drejtorëve të N.P.-së përkatëse më shumë se 9 (nëntë) vite nga zgjedhja e parë e tij/saj;
- Është i afërt i shkallës së 4 (katërt) (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e 'Interesit Financiar' në nenin 2 të këtij ligji) i cilitdo person që i takon cilëndo nga kategoritë e mësipërme;
- Është zyrtar, drejtor, ose aksionar, ose ka interes financiar në shoqëri tregtare të palistuar dhe që konkurron në ndërmarrje ose menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se 2% (dy përqind) të të drejtave të votimit, ose ka interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuar që konkurrojnë në ndërmarrje;
- Është ose, në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit, ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik, bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesit që për nga natyra do të shkaktohet që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutine, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve në N.P.

### **DOKUMENTET E KERKUARA**

- CV;
- Letër motivuese;
- Deklaratë nën betim (formular që plotësohet në moment e dorëzimit të dokumentacionit);
- Dëshmitë e kualifikimit profesional;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës;
- Certifikatën që nuk është nën hetime;
- Kopjen e dokumentit identifikues;

- Aplikuesi duhet të përgatitë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron që ai/ajo përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësinë dhe përgatitjen profesionale.
- Çdo informata e pavërtetë materiale qoftë e qëllimshme, qoftë nga neglizhenca, do të rezultojë me diskualifikim të menjëhershëm.

Formularët e aplikimit mund të sigurohen në Zyrën Nr. 10, Qendra për Shërbim me Qytetarë në objektin e Komunës së Mitrovicës Jugore si dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës <https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/>.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në Zyrën Nr. 10, Qendra për Shërbim me Qytetarë në objektin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, Rr. “Bedri Gjinaj” – Mitrovicë, ose me Postë (Kodi Postal: 40000).

Të gjitha dokumentacionet e dorëzuara në zarf të hapur nuk do të merren në shqyrtim dhe do të konsiderohen të pavlefshme.

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, origjinali duhet të prezantohet gjatë intervistimit. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret sipas këtij konkursi do të kualifikohen për fazat e mëtejshme.

Afati i aplikimit është i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas publikimit të shpalljes publike.

**Vërejtje:**

**KANDIDATËT QË KAN APLIKUAR MË PARË PËR KËTO POZITA NË KONKURSION E DT. 17.08.2022 NUK KANË NEVOJË TË APLIKOJNË PËRSËRI.**

Mitrovicë

19.09.2022

Kryesuesi i Komisionit

Xhafer PRETANI

